ALBCHROME HOLDING SH.P.K.

Raporti i audituesit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare individuale më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

Raporti i audituesit të pavarur ..... i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar 1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjitheperfshirese 2
Pasqyra ndryshimeve ne kapital 3
Pasqyra e flukseve te parase 4
1. INFORMACION MBI SHOQËRINË 5
2. BAZA E PËRGATITJES 6
3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME 7
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL 8
5. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET 13
6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE 14
7. INVESTIME NË FILIALE DHE PJESËMARRJE 14
8. TË DREJTA NDAJ PALËVE TË LIDHURA 15
9. LLOGARI TË ARKËTUESHME 15
10. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA 15
11. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE 15
12. KAPITALI AKSIONAR 15
13. DETYRIME NDAJ PALËVE TË LIDHURA 16
14. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA TË PAGUESHME 16
15. DETYRIME PËR TATIME DHE TAKSA 16
16. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT 17
17. SHPENZIME PERSONELI 17
18. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE 17
19. TATIMI MBI FITIMIN 17
20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHËZUARA 18
21. PALËT E LIDHURA 18
22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR 19
24. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT 23

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Albchrome Holding sh.p.k.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Albchrome Holding sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyre më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikes për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikes për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) qe janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike ne përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit qe kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhëne një baze për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrolle të brendshme qe drejtimi i gjykon të nevojshme për të bere të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare qe nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet qe kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidoje Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa me sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë qe të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi qe përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci qe një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoje gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra se bashku, pritet qe në mënyre të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi qe është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një baze për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është me i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshije marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm qe ka të beje me auditimin me qellim qe të përcaktojmë procedurat e auditimit qe janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes se një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyesh mërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marre, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhe dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin qe ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marre deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë qe Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshire informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyre qe arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohen e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshire ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm qe në mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Nexia AL shpk
Auditues Ligjor
Orjana Kalaja

Tirana, Albania
7 janar 2022

Nexia AL
K91701010Q

ALBCHROME HOLDING SHPK
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2021
(shumat janë në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktivet			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	-	63.753
Investime në filiale dhe pjesëmarrje	7	2.981.540.617	458.036.070
Totali i aktiveve afatgjata		**2.981.540.617**	**458.099.823**
Aktive afatshkurtra			
Të drejta ndaj palëve të lidhura	8	1.133.515	12.995.755
Llogari të arkëtueshme	9	-	10.200.000
Llogari të arketueshme të tjera	10	1.310.919	1.313.016
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11	227.067	774.992
Totali i aktiveve afatshkurtra		**2.671.501**	**25.283.763**
Totali i aktiveve		**2.984.212.118**	**483,383,586**
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	12	2.982.418.805	459.117.040
Fitimet e pashpërndara		1.559.105	3.499.590
Totali i kapitalit		**2.983.977.910**	**462.616.630**
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj palëve të lidhura	13	-	20.000.000
Llogari të pagueshme dhe të tjera	14	158.412	666.949
Detyrime për tatime dhe taksa	15	75.796	100.007
Totali i detyrimeve afatshkurta		**234.208**	**20.766.956**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**2.984.212.118**	**483.383.586**

Pasqyrat Financiare në faqet 1 deri 4 janë firmosur dhe aprovuar më 7 janar 2022 nga:

Blerina Daka
Administrator i Përgjithshëm

Dallandyshe Ismaili
Përgjegjës i Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen qe mbyllet me 31 dhjetor 2021
(shumat janë në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjitheperfshirese

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Te ardhura nga dividentet	16	2.412.945.897	-
Të ardhurat nga kontratat me klientët	17	6.000.000	6.000.000
Totali i të ardhurave		**2.418.945.897**	**6.000.000**
Shpenzime personeli	18	(502.975)	(489.483)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19	(901.961)	(612.776)
Shpenzime amortizimi	6	(25.955)	(26.402)
Fitimi nga aktiviteti i shfrytëzimit		**2.417.515.006**	**4.871.339**
Të ardhura financiare		14.564.930	10.957.082
Shpenzime financiare		(20.282.932)	(11.669.306)
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto		**(5.718.002)**	**(712.224)**
Fitimi para tatimit		**2.411.797.004**	**4.159.115**
Tatimi mbi fitimin	20	-	(623.867)
Fitimi neto për vitin financiar		**2.411.797.004**	**3.535.248**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse		**2.411.797.004**	**3.535.248**

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK
Pasqyra ndryshimeve ne kapital me 31 dhjetor 2021
(shumat janë në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra ndryshimeve ne kapital

	Kapitali i nënshkruar	Kapital i paguar i paregjistruar	Fitimet e pashpërndara	Totali
Më 1 janar 2020	**354.139.440**	**-**	**1.086.771**	**355.226.211**
Fitimi i vitit	-	-	3.535.248	3.535.248
Dividendë të paguar	-	-	(1.122.429)	(1.122.429)
Rritje kapitali	-	104.977.600	-	104.977.600
Më 31 dhjetor 2020	**354.139.440**	**104.977.600**	**3.499.590**	**462.616.630**
Fitimi i vitit	-	-	2.411.797.004	2.411.797.004
Dividendë të paguar	-	-	(2.413.737.489)	(2.413.737.489)
Regjistrimi kapitalit te paguar 2020	104.977.600	(104.977.600)	-	-
Rritje kapitali	2.523.301.765	-	-	2.523.301.765
Më 31 dhjetor 2021	**2.982.418.805**	**-**	**1.559.105**	**2.983.977.910**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBCHROME HOLDING SHPK
Pasqyra e flukseve te parase me 31 dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e flukseve te parase

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parase nga veprimtarite shfrytezuese		
Fitimi para tatimit	2.411.797.004	4.159.115
Rregullime per zerat jo-monetare:		
Amortizimi	25.955	26.402
Zhvleresimi I llogarive te arketueshme	-	-
Humbje nga investimet	-	-
	2.411.822.959	**4.185.517**
Ndryshimet ne kapitalin qarkullues		
Te arketueshme ndaj paleve te lidhura	11.862.240	53.463.266
Llogari te arketueshme	10.200.000	(1.200.000)
Llogari te arketueshme te tjera	2.097	623.867
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	(20.000.000)	654.117
Llogari te pagueshme dhe te tjera	(508.537)	273.294
Detyrime per tatime dhe taksa	(24.211)	(623.867)
Flukset neto nga veprimtarite e shfrytëzimit	**2.413.354.548**	**57.376.194**
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Shitje Aktive Afatgjata	37.798	-
Blerje kuotash në shoqëri me pjesëmarrje	(2.523.504.547)	(161.416.070)
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	**(2.523.466.749)**	**(161.416.070)**
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Shpërndarje dividenti	(2.413.737.489)	(1.122.429)
Rritja e kapitalit	2.523.301.765	104.977.600
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	**109.564.276**	**103.855.171**
Zvogelimi neto i flukseve të parasë	(547.925)	(184.705)
Mjete monetare në fillim të periudhës	774.992	959.697
Mjete monetare në fund të periudhës	**227.067**	**774.992**

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 23, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION MBI SHOQËRINË

Shoqëria "Albchrome Holding sh.p.k."(këtu më poshtë "Shoqëria") është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 15 janar 2015 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L51320005G.

Objekti i Shoqërisë është administrimi dhe financimi i minierave, impianteve, uzinave dhe fabrikave. Aksioner i vetëm i shoqërisë është shoqëria Balfin sh.p.k. e cila zotëron 100% të aksioneve. Vlera e aksioneve të Shoqërisë me 31 dhjetor 2021 është 2.982.418.805 Lekë (31 dhjetor 2020: 354.139.440 Lekë i paguar i regjistruar dhe 104.977.600 Lekë i paguar i paregjistruar). Shoqëria administrohet nga Znj. Blerina Daka.

Adresa kryesore e Shoqërisë është: Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3,Kati I, Ap 3.

Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria kishte 2 punonjës (2020: 2 punonjës).

1.1 Marrëveshjet koncensionare

Me nënshkrimin e marrëveshjes koncensionare është krijuar shoqëria koncensionare "Albchrome shpk" themeluar më 4 prill 2000, më vendim të gjykatës së rrethit të Tiranës 23.729, për administrimin e të dyja kontratave koncensionare .

Më 25 shkurt 2013 ACR Holding SRL-Itali u ble plotësisht nga Balfin sh.p.k. Më 14 nëntor 2016 u bë transferimi brenda grupit i 100% të kuotave të shoqërisë koncensionare "Albchrome shpk" nga ACR Holding SRL-Itali (shitësi) tek Shoqëria ("Albchrome Holding shpk" - blerësi). Me transferimin e kuotave janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë.

Nëpërmjet miratimit me nr. prot. 5541/6 datë 11 nëntor 2016 Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka autorizuar transferimin e Marrëveshjes Koncensionare nga ACR Holding s.r.l. tek Albchrome Holding sh.p.k. si dhe barrësimin e kuotave të Shoqërisë Koncensionare "Albchrome shpk".

Në këtë mënyrë Shoqëria mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me marrëveshjet koncensionare të nënshkruara ndërmjet autoritetit kontraktues dhe shitësit (ACR Holding s.r.l.), si më poshtë:

- Më 1 qershor 2000 është marrë në zotërim koncensioni i tipit BOT (Ndërto-Opero-Transfero) për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk me një vlerë monetare prej Lekë 168.000 mijë. Kjo marreveshje koncensionare eshte aprovuar me ligjin nr. 8590 date 23.03.2000 *"Për miratimin e Marrëveshjes së Koncensionit të formës BOT për Uzinën e Ferrokromit në Elbasan dhe për Minierat e Kromit në Prrenjas e Projsk, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane Darfo s.p.a" dhe dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncensionarin kësaj marrëveshje".*

- Më 22 qershor 2001 është marrë në zotërim koncensioni i tipit ROT (Rehabilito-Opero-Transfero), për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Bulqizë, një fabrikë mineralesh të çmuara në Bulqizë, një zonë e veçuar me minerale në Klos dhe fabrikën e ferro-kromit në Burrel me një vlerë monetare prej Lekë 248.000 mijë. Kjo marrëveshje koncensionare është aprovuar me Ligjin nr. Nr.8791, datë 10.5.2001*,"Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të tipit ROT të minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit Klos dhe të uzinës së ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane Darfo s.p.a" dhe dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncensionarin kësaj marrëveshje".*

- Më 25 korrik 2016. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi zgjatjen e periudhës së koncensionit deri më 31 dhjetor 2040.

Shoqëria nëpërmjet shoqërisë koncensionare "Albchrome shpk" detyrohet që me përfundimin e periudhës së koncensionit t'i transferoj Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA) të rehabilituar objektet e marra në koncesion.

2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, shprehur në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe.

2.1. Shoqëri të kontrolluara dhe konsolidimi

Shoqëri të kontrolluara janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria, ndërkohë shoqëria ka dhe investime në sipërmarrje të përbashkëta ku ushtrohet kontroll i përbashkët. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejtë ose indirekt, që të drejtojë politikat operacionale dhe financiare të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitimet nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Shoqëria si shoqëri mëmë e Albchrome Sh.p.k nuk është e detyruar të paraqesë pasqyrat financiare të konsoliduara nëse shoqëria mëmë e vet (Balfin Sh.p.k) harton pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Shoqëria përgatit vetëm pasqyra financiare individuale, dhe aktivitetet e filialeve të saj janë të konsoliduara në Pasqyrat Financiare të mëmës përfundimtare, Balfin shpk që publikon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim të publikut, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Interesat në shoqëri të kontrolluara dhe sipërmarrje të përbashkëta janë të regjistruara me kosto në pasqyrat individuale.

Riorganizimi i grupit dhe transferimi i shoqërive të kontrolluara

Balfin sh.p.k si një shoqëri mëmë (holding) të një numri filialesh që i zotëron në mënyrë direkte ose indirekte, mund të ndërmarrë riorganizime të strukturës zotëruese brenda kompanive të grupit. Këto ri-organizime kryhen për arsye të ndryshme si përmirësimi i koordinimit midis bizneseve, përmirësimi i strukturës së mbikqyrjes se tyre, krijimi i shoqërive ligjore për të ushtruar një biznes specifik e të tjera.

Transferimet e pronësisë brenda grupit kur kontrolli efektiv nuk ndryshon, mund të bëhen me ose pa pagesë, në formën e kontributit apo shpërndarjes. Këto transferime dhe ristrukturime të formës ligjore të pronësisë nuk kanë asnjë ndikim në strukturën e konsoliduar të grupit dhe nuk shkaktojnë të ardhura apo shpenzime. Për këtë arsye, këto transferime kryhen me vlerën kontabël në pasqyrat individuale të kompanive duke qenë se thelbi ekonomik i transaksionit është riorganizimi i grupit dhe jo gjenerimi i fitimit.

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

Tatim fitimi

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatimit fitimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrime për çështje të pritshme të kontrollit tatimor bazuar në vlerësimet se tatime shtesë do mund të lindin si detyrime. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria aplikon gjykimet e mëposhtme të cilat ndikojnë në mënyrë të rëndësishme përcaktimin e shumës dhe kohës për njohjen e të ardhurave nga kontratat me klientët:

Identifikimi i detyrimeve të performancës

Shoqëria ka kontratë shërbimi vetëm me Albchrome sh.p.k. ku zotëron dhe 100% të aksioneve, duke qenë kështu aksioneri i vetëm.

Kontratat për kryerjen e shërbimeve përbëjnë një detyrim të veçantë të performancës, i aftë për të qenë i dallueshëm dhe veçmas i identifikueshëm. Prandaj, Shoqëria cakton çmimin e transaksionit bazuar në çmimin e pavarur së shitjes të shërbimeve.

Natyra dhe koha e përmbushjes së kushteve të performancës

Shoqëria gjykon se të ardhurat nga shërbimet do të njihen me kalimin e kohës, sepse klienti në të njëjtën kohë merr dhe konsumon përfitimet e siguruara nga Shoqëria. Fakti që një njësi tjetër nuk do të ketë nevojë të ri-kryejë shërbimet që Shoqëria ka dhënë deri më sot tregon se klienti në të njëjtën kohë merr dhe konsumon përfitimet e realizimit të kontratës nga Shoqëria gjatë kryerjes së tij.

Shoqëria ka përcaktuar se metoda e inputit është metoda më e mirë në matjen e progresit të shërbimeve sepse ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis përpjekjeve të Shoqërisë (orëve të punës) dhe transferimin e shërbimit ndaj klientit. Shoqëria njeh të ardhurat në baza mujore.

Përcaktimi i shumave të ndryshueshme

Shoqëria mund të ketë të drejtën e një gjobe për pagesat me vonesë sipas kontratave të saj me klientët, e cila është vlerësuar duke përdorur metodën 'shuma më e mundshme'. Meqë kjo shumë e ndryshueshme nuk konsiderohet e mundshme të ndodhë, Shoqëria nuk ka përfshirë këto shuma në çmimin e transaksionit të saj.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lekë, që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lekë, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

	31 Dhjetor 2021	**31 Dhjetor 2020**
EURO	120.76	123,70
USD	106.54	100,84

(b) Aktivet afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevëndësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjes të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

iii) Amortizimi (vazhdim)

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Paisje Informatike	25%
Mjete Transporti	20%

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

(c) Investime në *shoqeri te kontrolluara* dhe sipërmarrje të përbashkëta

i) Njohja dhe matja

Investimet në shoqëri të kontrolluara

Investimet në *shoqëri të* kontrolluara janë investime ku Shoqëria zoteron kontrollin. Treguesi i kontrollit është kryesisht zotërimi i mbi 50% te kapitalit aksionar. Kontrolli arrihet kur shoqëria është e ekspozuar ose ka të drejta për kthime të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarin dhe ka aftësinë për të ndikuar në këto kthime nëpërmjet fuqisë së saj mbi të investuarin. Për investimet në *shoqëri të* kontrolluara shoqëria ka përdorur metodën e kostos, minus humbjet nga zhvlerësimi. Nga shitja e investimeve në *shoqëri të* kontrolluara, diferenca ndërmjet cmimit të shitjes dhe vlerës kontabël njihet si fitim humbje e periudhës.

Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta

Investimet në sipërmarrje të përbashkëta janë marrëveshje ku Shoqëria ka ndarë me një shoqëri tjetër kontrollin e përbashkët mbi aktivitetin ekonomik të shoqërisë. Në bazë të marrëveshjes palët kanë të drejta në aktivet neto sipas kësaj marrëveshje. Kontrolli i përbashkët është ndarja, sipas një marrëveshjeje kontraktuale, e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe të shfrytëzimit që lidhen me aktivitetin kërkojnë pëlqimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

Investimet në sipërmarrje të përbashkëta njihen me metodën e kapitalit neto, në njohjen fillestare të investimit, ku në fillim njihet me kosto dhe vlera kontabël rritet apo ulet për të njohur pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e të investuarit pas datës së blerjes.

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare invididuale dhe nuk ka bërë konsolidimin e investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, duke qenë se konsolidimi do të kryhet nga shoqëria mëmë "Balfin shpk".

ii) Të ardhurat nga dividentët

Shoqëria njeh të ardhurat nga dividendët nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje është njihen në fitim ose humbje në të saj pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike nëse përcaktohet e drejta e saj e njësisë ekonomike për të arkëtuar dividendin. Dividendi njihet në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur njësia zgjedh të përdorë metodën e kapitalit neto. Në këtë rast dividendi njihet si pakësim i vlerës kontabël neto të investimit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregëtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njësitë ekonomike të grupit.

Aktivet Financiare

i) Njohja dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike te standartit, Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus kostot e transaksionit, kjo në rastin e një aktivi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për manaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregëtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

ii) Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes se mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktivet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

Aktivet Financiare (vazhdim)

i) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

ii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria ka vetëm të arkëtueshme me palët e lidhura ndaj dhe humbja e pritshme e kredisë (ECL) është vlerësuar si jomateriale.

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet i borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë, megjithatë gjykimi bëhet rast pas rasti në varësi të kërkesave të likuiditetit të palëve të lidhura. Një aktiv financiar shlyhet kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

Detyrimet Financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, dhe të tjera të pagueshme të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

i) Matjet e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, dhe nuk ka ndonjë hua apo huamarrje.

ii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anullohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Llogaritë e arkëtueshme

Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme që është e pakushtëzuar (dmth., kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës). Referojuni politikave kontabël të aktiveve financiare në seksionin *b) Instrumentet financiarë.*

(f) Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjendjet e arkës dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para në arkë dhe bankë.

(g) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

(h) SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 zëvendëson SNK 11 *"Kontratat e ndërtimit*, SNK 18 *"Të ardhurat"* dhe të gjitha interpretimet e lidhura me to, dhe është i aplikueshëm, me përjashtime të vogla, mbi të gjitha të ardhurat qe rrjedhin prej kontratave me klientët. SNRF 15 përcakton një model me pesë hapa për njohjen e të ardhurave që rrjedhin prej kontratave me klientët dhe kërkon që të ardhurat të njihen në ato vlera të cilat reflektojnë pretendimin që një shoqëri ka në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve. SNRF 15 kërkon që shoqëritë të përdorin gjykime, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat domethënëse gjatë aplikimit të secilit prej hapave të modelit. Albchrome Holding ka vlerësuar efektin e SNRF 15 dhe ka dalë në konkluzion se ky standard nuk ka efekte materiale për arsye se:

a) Albchrome Holding ka si të ardhura kryesore dividend që merr nga Operatori i koncesionit që nuk janë nën fushëveprimin e këtij standarti.

b) të ardhurat e tjera nuk janë materiale

Gjjithsesi, standardi është zbatuar duke përdorur metodën e aplikimit me efekt retrospektiv me datë efektive 1 janar 2017.

(i) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet dhe sigurimin shëndetësor në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse kur ndodhin.

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare, dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

(k) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm te vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(l) SNRF 16 Qiratë

Kompania ka aplikuar SNRF 16 për herë të parë që nga janari 2019. Natyra dhe efektet e ndryshimit si rezultat i aplikimit të këtij standardi të ri të kontabilitetit janë përshkruar si më poshtë. Përvec ndryshimeve të përmendura më poshtë, politikat kontabël të zbatuara janë konsistente me ato të një viti më parë. Disa amendime të tjera dhe interpretime të zbatuara për herë të parë në 2019, por nuk kanë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka zbatuar më herët ndonjë standard, interpretim apo amendim që është nxjerrë, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 Qiratë është nxjerrë në Janar 2016 dhe zevëndëson SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban qira, KIS-15 Qiratë Operacionale-Incentivat dhe KIS-27 Vlerësimi i Subtancës së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe shpalosjen e qirave dhe kërkon që qiradhënësi të kontabilizoj për të giitha qiratë nën një zë të vetëm në bilanc, njëlloj si kontabilizimi për qiratë financiare sipas SNK 17.

Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësin-qiratë me vlerë të ulët (p.sh. kompjuteri personal) dhe qiratë afatshkurtër (p.sh. qiratë me afat maturimi 12 muaj ose më pak). Në datën e fillimit të qirasë, qiramarrësi njeh detyrimin për të kryer pagesat e qirasë (p.sh. detyrimi i qirasë) dhe një aktiv që përfaqëson të drejtën për të përdorur aktivin përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. (p.sh. aktiv me të drejtë përdorimi) .Qiramarrësit duhet të njohin vecmas shpenzimet e interesit për detyrimin e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejtën e përdorimit të aktivit.

Kontabilizmi i qiradhënësit sipas SRNF 16 është kryesisht i pa ndryshuar nga kontabilizimi sipas SNK 17. Qiramarrësi do të vijoj tëe klasifikoj të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si tek SNK 17 dhe dallimin midis dy tipeve të qirasë: qira financiare dhe operacionale.

Një qiramarrës mund të zgjedhi të zbatoj standardin duke përdorur në mënyrë retrospektive për çdo periudhë raportimi të paraqitur ose në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi në datën e zbatimit për herë të parë.

Menaxhimi ka kryer një vlerësim mbi efektet e zbatimit të standardit të ri SNRF 16 dhe gjykon që ky standard nuk ka impakt per Shoqërinë. Shoqëria ka vetëm një kontratë qiramarrje për zyrat qëndrore për të cilat është aplikuar përjashtimi për njohjen, si qira me vlerë të ulët.

5. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET

Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Janar 2021

- Përditësime të Referencimeve në Kuadrin Konceptual të standardeve SNRF 1 Janar 2021
- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 (Ndryshim në SNRF 16) 1 Qershor 2020
- Reforma e Normës së Interesit Referuese (Perditesime në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) 1 Janar 2021

Standardet e reja që mund të adoptohen më herët ende të paadoptuara nga BE

- Përkufizimi i nje Biznesi (Përditësime të SNRF 3) 1 Janar 2022
- Përmirësimet vjetore 2018-2020 1 Janar 2022
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" 1 Janar 2023
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjata (Perditesime në SNK 1) 1 Janar 2023
- Politika kontabël, ndryshime në gjykime dhe vlerësime dhe gabimet ((Perditesime në SNK 1 dhe SNK 8) 1 Janar 2023

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Paisje kompjuterike	Totali
Kosto		
Me 1 janar 2020	172.558	172.558
Shtesa	-	-
Shitje	-	-
Më 31 dhjetor 2020	**172.558**	**172.558**
Shtesa		
Shitje	(172.558)	(172.558)
Më 31 dhjetor 2021	**-**	**-**
Amortizimi i akumuluar		
Me 1 janar 2020	**82.403**	**82.403**
Amortizimi për vitin	26.402	26.402
Më 31 dhjetor 2020	**108.805**	**108.805**
Amortizimi për vitin	25.955	25.955
Rimarrje e amortizimit	(134.760)	(134.760)
Më 31 dhjetor 2021	**-**	**-**
Vlera kontabel neto:		
Më 31 dhjetor 2020	**63.753**	**63.753**
Më 31 dhjetor 2021	**-**	**-**

7. INVESTIME NË FILIALE DHE PJESËMARRJE

Investimet në shoqëri të kontrolluara përfshijnë investimet e mbajtura me vlerën e investimit në koston historike. Kosto historike e tyre përfshin investimin ne vleren fillestare me kursin historik te tij ne kohen e kryerjes se investimit.

Albchrome shpk

Shoqëria zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë "Albchrome shpk" në vlerën 2.684.565.897 Lekë (31 dhjetor 2020: 271.620.000 Lekë). Vlera e këtij investimi është rritur gjatë periudhës që mbyllet më 31 dhjetor 2021, me vlerën e kontributit në para të kryer nga Shoqëria mëmë në vlerën 2.412.945.897 Lekë.

	Investimi
Vlera e investimit ne Alchrome shpk më 01.01.2021	***271.620.000***
Kontributi në para ne kapitalin e Shoqërisë Albchrome shpk	2.412.945.897
Vlera e investimit ne Alchrome shpk më 31.12.2021	**2.684.565.897**

Vlahen Mining shpk

Shoqëria zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë "Vllahen Mining shpk" në vlerën 296.974.720 Lekë (31 dhjetor 2020: 186,416,070 Lekë). Vlera e këtij investimi është rritur gjatë periudhës që mbyllet më 31 dhjetor 2021, me vlerën e kontributit në para të kryer nga Shoqëria mëmë në vlerën 110.558.650 Lekë.

	Investimi
Vlera e investimit ne Vllahen Mining shpk më 01.01.2021	***186.416.070***
Kontributi në para ne kapitalin e Shoqërisë Vllahen Mining shpk	110.558.650
Vlera e investimit ne Vllahen Mining shpk më 31.12.2021	**296.974.720**

8. TË ARKËTUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të arkëtushme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 janë 1.133.515 lekë dhe 31 dhjetor 2020 ishin 12.995.755 lekë.

9. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme për vitin 2021 janë në vlerën 0 Lekë (2020: 10.200.000 Lekë) përbëhet nga të drejtat ndaj Albchrome shpk për shërbimet e konsulencës dhe manaxhimit.

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagim tatim fitimi	1.191.183	1.191.183
Tatimi mbi të ardhurat personale	78.231	78.231
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	41.505	43.602
Totali	**1.310.919**	**1.313.016**

Të arketueshmet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ju përkasin balancave kreditore me tatimet për shkak të parapagimeve të këtyre detyrimeve në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

11. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE

Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Vlera në arkë	**-**	**-**
Vlera në banka	**227.067**	**774.992**
Në Lekë	197.850	579.365
Në Usd	1.808	3.030
Në Euro	27.409	192.597
Totali	**227.067**	**774.992**

12. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i paguar më 31 dhjetor 2021 është në vlerën 2.982.418.805 Lekë (31 dhjetor 2020: 354.139.440 Lekë i paguar dhe regjistruar dhe 104.977.600 Lekë i paregjistruar).

Zmadhimet e kapitalit të shoqërisë nga Shoqeria mëmë gjatë periudhës deri më 31 dhjetor 2021 janë si vijon:

Data e vendimit për kontributin në para për rritje kapitali	Shuma
22.04.2021	51.579.980
21.06.2021	24.535.248
14.07.2021	10.800.000
22.07.2021	2.412.945.897
08.11.2021	23.440.640
Totali	**2.523.301.765**

12. KAPITALI AKSIONAR (VAZHDIM)

Dividenti i shpërndarë për pronarët e shoqërisë gjatë vitit 2021 është në vlerën 2.413.737.489 lekë, në zbatim të vendimit të aksionerëve nr.4 datë 22.06.2021 për shpërndarjen e rezultatit të vitit 2020 në vlerën 3,535,248 Lek dhe vendimin e aksionerëve nr 7 datë 23.08.2021 për shpërndarjen e rezultatit të ndërmjetëm në vlerën 2.410.202.241 lekë.

Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e aksionarit të Shoqërisë dhe kontributin te tij të bërë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	% e Kapitalit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aksionarët			
BALFIN	100%	2.982.418.805	459.117.040
Totali	**100%**	**2.982.418.805**	**459.117.040**

13. DETYRIME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Dividentë të pagueshëm	-	20.000.000
Totali	**-**	**20.000.000**

14. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të pagueshme	-	59.056
Të pagueshme ndaj punonjësve	158.412	607.893
Totali	**158.412**	**666.949**

15. DETYRIME PËR TATIME DHE TAKSA

Detyrime për tatime dhe taksa përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
TVSH e pagueshme, neto	75.796	100.007
Totali	**75.796**	**100.007**

16. TË ARDHURAT NGA DIVIDENTËT

Të ardhurat nga dividentët më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Dividend nga Albchrome shpk	2.412.945.897	-
Totali	**2.412.945.897**	**-**

17. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT

Të ardhurat nga kontratat me klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë në vlerën 6.000.000 Lekë (2020: 6.000.000 Lekë) përfaqësojnë shërbimet e manaxhimit dhe konsulencës për shoqërinë Albchrome shpk.

18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	494.568	474.000
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	8.407	8.064
Shpenzime të tjera stafi	-	7.419
Totali	**502.975**	**489.483**

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Shpenzime të përgjithshme administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 djetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	-	-
Shpenzim për qira	192.917	190.507
Shpenzime konsulence	521.164	234.500
Tarifa dhe taksa vendore	112.100	112.100
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	-	-
Shpenzime të tjera bankare	75.780	75.669
Mirëmbajtje dhe riparime	-	-
Totali	**901.961**	**612.776**

20. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i llogaritur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas legjislacionin fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit		**2.411.797.004**		**4.159.116**
Tatimi fillestar me 15%	15.00%	361.769.550	15.00%	623.867
Axhustime:		-		
Efekti të ardhurave të patatushme	-15.00%	(361.941.884)		
Efekti i shpenzimeve të panjohura	0.00%	-	0.00%	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		**-**		**623.867**

21. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHËZUARA

Cështje gjyqësore

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

Angazhimet operative të qirasë - Shoqëria si qiramarrëse

Shoqëria ka vetëm një kontratë qiraje për zyrat qëndrore me një afat 3 vjecar. Kontrata e qirasë maturohet brenda një afati 12 mujor por Shoqëria vlereson që ekziston mundësia që kontrata e qirasë të rinovohet vijoj përtej këtij afati. Megjithatë, ne baze te perjashtimeve te njohjes referuar paragrafit 5 dhe 6 te Standardit Nderkombetari te Raportimit. Shoqëria për shkak të vlerës së ulët aplikon përjashtimin në njohjen e qirasë.

	31 dhjetor 2021	**31 dhjetor 2020**
Brenda vitit	192.917	192,972
Pas një viti por jo më shumë se pesë vite	376.771	578,916
Totali	**569.688**	**771,888**

22. PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura të Grupit Balfin. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtarë dhe në normat e tregut. Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transaksionet me Albchrome shpk, Balfin shpk dhe Vllahen Mining.Të arkëtueshmet me palët e lidhura konsistojnë në të ardhurat nga shërbimet e konsulencës, të arkëtueshmet për dividentë të deklaruar por akoma të papaguar, ndërkohë detyrimet i përkasin blerjeve për nevoja operative nga kompanitë brenda grupit.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	**31 dhjetor 2020**
Të drejta:		
Llogari të arkëtueshme	-	10.200.000
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	1.133.515	12.995.755
Detyrime:		
Llogari të pagueshme	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	-	20.000.000

Volumi me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	**Viti i mbyllyr më 31 dhjetor 2020**
Shitje:		
Të ardhurat nga kontratat me klientët	6.000.000	6.000.000
Të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	37.798	-
Totali	**6.037.798**	**6.000.000**
Blerje:		
Aktive afatgjata materiale	-	-
Shpenzime të tjera të personelit	-	7.419
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	192.917	192.738
Totali	**192.917**	**200.157**

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proçeset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe proçedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Meqë Shoqëria ka marrëdhënie vetëm me palët e lidhura risku i kredisë është i ulët. Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta matet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balancave të llogarive tëarkëtueshme. Mosarkëtimi i llogarive të arkëtueshme nuk është probable ndaj dhe shoqëria nuk llogarit zhvlerësim.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2021	**31 dhjetor 2020**
Të drejta ndaj palëve të lidhura	1.133.515	12.995.755
Llogari të arkëtueshme	-	10.200.000
Të arkëtueshme të tjera	1.310.919	1.313.016
Mjete monetare dhe ekuivalentë	227.067	774.992
Totali	**2.671.501**	**25.283.763**

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë. Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm. Gjithashtu, ajo nuk ka detyrime të rëndësishme ndaj palëve të treta.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Aktivet dhe detyrimet financiare, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021			
	Me pak se 3 muaj	**3 deri 12 muaj**	**Mbi 1 vit**	**Totali**
Të drejta ndaj palëve të lidhura	1.133.515	-	-	1.133.515
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	**-**
Llogari të arkëtueshme të tjera	-	-	1.310.919	1.310.919
Mjete monetare dhe ekuivalentë	227.067	-	-	227.067
Totali	**1.360.582**	**-**	**1.310.919**	**2.671.501**
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	-	-	-	**-**
Llogari të pagueshme dhe të tjera	158.412	-	-	158.412
Detyrime për tatime dhe taksa	75.796	-	-	75.796
Totali	**234.208**	**-**	**-**	**234.208**
Hendeku i Likuiditetit	**1.126.374**	**-**	**1.310.919**	**2.437.293**

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2020			
	Me pak se 3 muaj	**3 deri 12 muaj**	**Mbi 1 vit**	**Totali**
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	12.995.755	-	12.995.755
Llogari të arkëtueshme	10.200.000	-	-	10.200.000
Llogari të arkëtueshme të tjera	118.942	1.194.074	-	1.313.016
Mjete monetare dhe ekuivalentë	774.992	-	-	774.992
Totali	**11.093.934**	**14.189.829**	**-**	**25.283.763**
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	-	20.000.000	-	20.000.000
Llogari të pagueshme dhe të tjera	666.949	-		666.949
Detyrime për tatime dhe taksa	100.007	-	-	100.007
Totali	**766.956**	**20.000.000**	**-**	**20.766.956**
Hendeku i Likuiditetit	**10.326.978**	**(5.810.171)**	**-**	**4.516.807**

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i cmimeve te mineraleve

Shoqëria është investuese në industrinë minerare, industri që është tepër sensitive ndaj luhatjeve të cmimit të tregut të mineraleve. Një rënie e theksuar në vlerë, mund të ndikojë në vlerën e investimeve te shoqërisë në filalet që operojnë në veprimtarinë minerare.

Shoqëria monitoron efektin e cmimeve të mineraleve në treg. Megjithate, vlera e të ardhurave të pritshme nga filialet është shumë herë më e madhe se kostoja e investimeve dhe investimeve në kapitalin e filialeve dhe nuk ekziston asnjë tregues se kjo kosto investimesh nuk do të jetë e rikuperueshme.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me rrezikun e normës së interesit pasi nuk ka huamarrje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro dhe Dollar nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbron Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga kyrrezik.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

23. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

	Më 31 dhjetor 2021			
	Lek	**Euro**	**Usd**	**Totali**
Të drejta ndaj palëve të lidhura	1.133.515	-	-	1.133.515
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	1.310.919	-	-	1.310.919
Mjete monetare dhe ekuivalentë	197.850	27.409	1.808	227.067
Totali	**2.642.284**	**27.409**	**1.808**	**2.671.501**
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	-	-	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	158.412	-	-	158.412
Detyrime per tatime dhe taksa	75.796	-	-	75.796
Totali	**234.208**	**-**	**-**	**234.208**
	2.408.076	**27.409**	**1.808**	**2.437.293**

	Më 31 dhjetor 2020			
	Lek	**Euro**	**Usd**	**Totali**
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	-	12.995.755	12.995.755
Llogari të arkëtueshme	10.200.000	-	-	10.200.000
Llogari të arkëtueshme të tjera	1.313.016	-	-	1.313.016
Mjete monetare dhe ekuivalentë	579.365	192.597	3.030	774.992
Totali	**12.092.381**	**192.597**	**12.998.785**	**25.283.763**
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	20.000.000	-	-	20.000.000
Llogari të pagueshme dhe të tjera	666.949	-		666.949
Detyrime per tatime dhe taksa	100.007	-	-	100.007
Totali	**20.766.956**	**-**	**-**	**20.766.956**
	(8.674.575)	**192.597**	**12.998.785**	**4.516.807**

Analiza e ndjeshmërisë

Më 31 dhjetor 2021 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e kursit te kembimit n me -/+ 5% do sillte një ndryshim në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin si vijon:

Analiza e ndjeshmërisë nga ndryshimi i kursit të këmbimit	**Efekti në fitimin para tatimit**	
	2021	**2020**
Rritje me (5%)	**1.460**	**659.569**
EUR	1.370	9.630
USD	90	649.939
Rënie me (5%)	**(1.460)**	**(659.569)**
EUR	(1.370)	(9.630)
USD	(90)	(649.939)

24. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Më 15 tetor 2021 Balfin ka përfunduar një marrëveshje për shitjen e aksioneve të Albchrome Holding me Yildirim International Mining Investments B.V, anëtar i Grupit të kompanive Yildirim, me seli në Turqi.

Përfundimi i transaksionit të shitjes së aksioneve te Albchrome Holding shpk do të realizohet mbas datës së raportimit të pasqyrave financiare, mbas dakordësimit për cmimin e shitjes të axhustuar sipas kritereve të përcaktuara në marrëveshje.

Përvec sa më sipër, nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kerkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.